



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 79.
Prishtinë, më 18.11.2013 në ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Elmi Reçica, Glauk Konjufca dhe Vesna Mikic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Lejla Selimi, përfaqësuesja e ECMI-së Lura Pollozhani, përfaqësues nga RTK 2 dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu, Fjolla Gashi - praktikante e UNDP-së .

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Živković –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 1.10.2013 dhe 8.10.2013;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-220 për Investimet e Huaja, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Shëdetesi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-102, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;**
6. **Te Ndryshme.**

Kryesuesja - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 1. dhe 8.10.2013.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 1.10.2013 dhe 18.10.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-220 për Investimet e Huaja, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim Projektligjin Nr.04/L-220 për Investimet e Huaja me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr.04/L-220 për Investimet e Huaja dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetesi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim Projektligjin për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Petar Miletic - bazuar në këtë projektligj, diskutimi i tij ishte se komisioni funksional nuk ka miratuar amendamentin 7. të nenit 3, paragrafi 1.20 . Ai propozoi që amendamenti 7, të përkrahet nga komisioni me tekstin siç përmban amendamenti në fjalë.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me shtatë vota 'për' dhe dy vota 'abstenim', miratoi këtë;

P ë r f u n d i m

- I. Projektligji për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. A) Komisioni shqyrtoi amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional dhe të njëjtat i përkrahu në tërësi, i me konstatim se nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

B) Komisioni shqyrtoi Amendamentin 7, të nenit 3, paragrafi 1.20 të propozuar nga GR-SLS, dhe të njëjtin e përkrah me tekstin si në vijim:

‘Grupet e cënueshme’ janë ato grupe që kërkojnë punë apo janë të papunë si : nëna me shumë fëmijë, nënat vetushqyese, personat me moshën mbi 50 vjeç, të rinjtë nën moshën 15 vjeçare, të kthyerit në Kosovë, personat e zhvendosur interno të pa punë një kohë të gjatë, të kthyerit dhe personat e zhvendosur interno dhe personat që marrin ndihma sociale.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-102, me amendamentet e Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-102 me amendamentet e Komisionit Funksional dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar shqyrtoi Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-102 dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme

Kryesuesja - e njoftoi komisionin se ka pas takim me përfaqësuesit e organizatës së OSB-së ku është diskutuar për mbajtjen e një punëtorie një ditore lidhur me hartimin e planit të punës së Komisionit për vitin 2014.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim murr qëndrim që punëtorja e punës për vitin 2014, të mbahet më 16.12.2013, në restorant Emerald, me mbështetje të organizatës së OSB –së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković